




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 308/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z.Goran Milenković– Kryetar, z.Nuhi Paçarizi-Referues, z.Blerim Dina-Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik N.P.SH. “Doni Term” – “Gafurr Jashari” B.I.– Drenas, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE: N.N.P.”B-Engineering” – Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ventilimi-Përdhese dhe KATI I –Korridoret e Ambulancës Specialistike të QKUK-së”, me numër të prokurimit: 701-19-2801-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Qendra Klinike Universitare e Kosovës-QKUK –QKUK, më datën 05.07.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik N.P.SH. “Doni Term” – “Gafurr Jashari” B.I.– Drenas, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ventilimi-Përdhese dhe KATI I –Korridoret e Ambulancës Specialistike të QKUK-së”, me numër të prokurimit: 701-19-2801-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –QKUK.

II. ANULOHET njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Ventilimi-Përdhese dhe KATI I –Korridoret e Ambulancës Specialistike të QKUK-së”, me numër të prokurimit: 701-19-2801-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – QKUK dhe aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues N.P.SH. "Doni Term" – "Gafurr Jashari" B.I. – Drenas, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë me dt: 03.05.2019

Hapja e ofertave është bërë me dt: 16.05.2019

Njoftimi me letër standarde për tenderues të pasuksesshëm dt: 22.05.2019

Kërkesë për rishqyrtim dt: 24.05.2019

Autoriteti Kontraktues me datën 03.06.2019 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues N.P.SH. "Doni Term" – "Gafurr Jashari" B.I. – Drenas, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 13.06.2019 me nr. 308/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE: N.N.P. "B-Engineering" – Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ventilimi-Përdhësa dhe KATI I – Korridoret e Ambulancës Specialistike të QKUK-së", me numër të prokurimit: 701-19-2801-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – QKUK, duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59, 60, 69, dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 20.06.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës

ankimore.

Ekspertja Shqyrtuesenë raportin e dt:21.06.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim:

OE ankues: "N.P.SH. Doni Term Gafurr Jashari"pretendon se Qendra Klinike Universitare e Kosovës, nuk ka respektuar nenin 7 të LPP-së,sipas OE.ankues .

Ekspertja thekson se qellim i këtij neni është trajtimi i barabartë dhe jo diskriminues i të gjithë ofertuesve , Operatorin ekonomik i propozuar për kontratë ka ofertuar me çmim ma të lirë se sa OE. ankues,andaj edhe vendimi i AK-së nuk ishte në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së .

Ekspertja konstaton ky pretendim është i pa bazuar .

OE ankues "N.P.SH. Doni Term Gafurr Jashari", pretendon se Qendra Klinike Universitare e Kosovës nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-së,sipas OE. ankues.

Ekspertja thekson se qellim i këtij neni është Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve,fillimisht autoriteti kontraktues ka themeluar komision të vlerësimit i cili ka vlerësuar dhe ka konstatuar se OE .i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar të gjitha kriteret e parapara me NJ.K. dhe DT. Andaj e ka rekomanduar për kontratë të cilin e ka aprovuar edhe Zyrtari përgjegjës i prokurimit.

Sa i përket pretendimit të OEankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka referencë për klimatizim dhe ventilim te realizuar në tri vitet e fundit i cili pretendon se e ka vetëm një kontratë edhe atë para tri viteve te fundit d.m.th te nënshkruar dhe te kryer ne vitin 2015 dhe referencën e nxjerr në vitin 2016 e cila është pa validitet.

Sa i përket këtij pretendimi shih kriterin:

Kapaciteti teknik dhe profesional

Kërkesa 1.Operatori Ekonomik ofertues duhet të ofrojë dëshmi listën e kontratave te natyrës se ngjashme te përfunduar me sukses ne tri vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit për kontratë.

Dëshmia e kërkuar dokumentare .

Evidenca 1.OE ofertues duhet që të ofroj si dëshmi listën e kontratave për punime te klimatizimit dhe ventilimit në institucione shëndetësore te realizuara me sukses në tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë , tëpërcjellura me referenca,apo raporte te pranimit .

OE i rekomanduar për kontratë ka sjellëListën e kontratave te ngjashme dhe dëshmitë -kontratat dhe referencat për realizimin e projekteve te cilat gjinden në shkresat e lendes .

Ekspertja konstaton se ky pretendim ështëi pa bazuar .

OE ankues "N.P.SH. Doni Term Gafurr Jashari",pretendon se Qendra Klinike Universitare e Kosovës nuk ka respektuar nenin 60 të LPP-së, sipas OEankues .

Ekspertja thekson se qellim i këtij neni është të respektohen kriteret për dhëniene kontratës dhe kriter për dhënien e kontratës ka qenë :

Tenderin epërgjegjshëmme çmiminmëtë ulët;

Edhe vendimi i AK-së ishte mbi këtë bazë.

Ekspertja konstaton ky pretendim është i pa bazuar .

OE ankues "N.P.SH. Doni Term Gafurr Jashari", pretendon se Qendra Klinike Universitare e Kosovës nuk ka respektuar nenin 69.4 të LPP-së,sipas OE. ankues.

Ekspertja sqaron se përmes këtij neni AK-së mund të kërkoj disa sqarime nga OE.te siguroj dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale te kërkuara me DT. dhe NJ.K. Aftësia teknike dhe profesionale e Ofertuesve andaj lidhur me pretendimin se nuk është zbatuar pika 4 e nenit 69ekëtij neni,që nënkuptonte kërkoj nga OE qe te sigurohet dëshmitë mbi aftësinë e tyre për sigurimin e shërbimeve .

Ekspertja mendon se pretendimi i OE.ankues nuk qëndron sepse OE. fitues i ka ofruare te gjitha kushtet - kriteret e parapara me NJ.K.dhe me D.T. (siç është sqaruar në përgjigjeje nr.2)

Ekspertja konstaton ky pretendim është i pa bazuar .

OE ankues "N.P.SH. Doni Term Gafurr Jashari",pretendon se Qendra Klinike Universitare e Kosovës nuk ka respektuar nenin 72 të LPP-së,sipas OE. ankues.

Ekspertja sqaron se në bazë të këtij neni mund të kërkojen sqarime dhe disa dokumente shtesë, Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

AK-së nuk ka pasur nevojëpër sqarime shtesë sepse te gjitha që gjinden në shkresat e lendes janë të mjaftueshme dhe nuk e ka pa të nevojshme te kërkojë sqarime edhe pse për disa dokumente ia mundëson ligji.

Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa bazuar.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertja shqyrtuese e prokurimit i propozon panelit shqyrtues që ankesën e lartpërmendur të operatorëve ekonomik,ta HUDHË POSHT -si të PA BAZUARË (për arsyen që u çekën te përgjigjet në secilin pretendim),dhe i rekomandon panelit shqyrtues që të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues .

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 24.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 25.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues sepajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 05.07.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues,përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertës shqyrtuese, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi iOE-së z. Jasharideklaroj:Ne qëndrojmë prapa ankesës sonë të dorëzuar ne OSHP, dhe ne mendojmë qe Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje ne lidhje me kërkesën në DT ku kërkohet nga OE-të qe të dorëzojnë një reference te klimitazimit dhe ventilimit ne institucionet shtetërore ne 3 vitet e fundit, OE i rekomanduar për kontratë ka paraqitur një reference e cila kontrata bazë është e nënshkruar me date 02.11.2015 dhe referencën e ka të lëshuar me datë 14.06.2016 ku kjo reference është lëshuar me vonese, sepse kontrata është përmbyllur ne vitin 2015 sepse ka qene fundi i vitit dhe pagesa është dashur te kryhet ne vitin 2015. Ndërsa referenca është lëshuar ne muajin e 6-të te vitit 2016 dhe kjo ndodhe kur OE kërkon nga Autoriteti Kontraktues për lëshimin e referencës dhe Autoriteti Kontraktues referencën e lëshon në datën kur OE e benë kërkesën. Për tu verifikuar qe kjo kontratë ka mundur të zgjate deri ne muajin e 6-të pa përfunduar këtë mund ta verifikoj vetëm raporti i pranimi teknik i cili përmban datën e saktë te punimeve, dhe ajo date mund të jetë data e përfundimit te punëve finale te projektit, sepse referencën mundemi te kërkojmë edhe me vone, ka pas raste ku edhe vet kam marr.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Maliqi deklaroj: Kam qenë i angazhuar në këtë lëndë për vlerësim, në si Autoritet Kontraktues qëndrojmë në tërësi pran ekspertizës së ekspertës, për ne ka qenë kriteri se paku një reference që të ketë një referencë në institucionet shëndetësore qëndron, kontrata është e vërtetë që është e nënshkruar në 2015 por realizimi i punimeve është bërë në vitin 2016.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: Propozoj që ankesa e jonë të aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së deklaroj: Kërkojmë që të hudhet poshtë ankesa e OE dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoriteti Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues profesional, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, lidhur me pretendimet e OE "N.P.SH. Doni Term Gafurr Jashari" se Qendra Klinike Universitare e Kosovës, nuk ka respektuar nenin 7 të LPP-së. Paneli shqyrtues konstaton se qëllim i këtij neni është trajtimi i barabartë dhe jo diskriminues i të gjithë ofertuesve, andaj me rastin e rivlerësimit AK duhet të trajtoj ofertuesit në mënyrë të barabartë dhe pa ndonjë diskriminim apo favorizim dhe se vlerësimin e ofertave duhet ta bëjë në pajtim me nenin 59 të LPP-së.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka referencë për klimatizim dhe ventilim të realizuar në tri vitet e fundit ku ankuesi pretendon se e ka vetëm një kontratë edhe atë para tri viteve të fundit d.m.th të nënshkruar dhe të kryer në vitin 2015 dhe referencën e nxjerr në vitin 2016 e cila është pa validitet.

Paneli shqyrtues konstaton se kriteri i vendosur në dosjen e tenderit nga ana e AK-së tek Kapaciteti teknik dhe profesional, është Kërkesa 1. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ofrojë dëshmi listën e kontratave të natyrës së ngjashme të përfunduar me sukses në tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.

Dëshmia e kërkuar dokumentare: Evidenca 1. OE ofertues duhet që të ofrojë si dëshmi listën e kontratave për punime të klimatizimit dhe ventilimit në institucione shëndetësore të realizuara me sukses në tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, të përcjellore me referenca, apo raporte të pranimit.

Paneli shqyrtues konstaton se me rastin e rivlerësimit autoriteti kontraktues duhet të vërtetojë se referenca dhe kontrata e kontestuar nga ankuesi është sipas kërkesës së dosjes së tenderit të autoriteti kontraktues.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "N.P.SH. Doni Term Gafurr Jashari", se Qendra Klinike Universitare e Kosovës nuk ka respektuar nenin 60 të LPP-së. Paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues mund të rekomandojë për dhënie të kontratës një operator ekonomik i cili ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe po ashtu ka ofertuar me çmim më të lirë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "N.P.SH. Doni Term Gafurr Jashari", se Qendra Klinike Universitare e Kosovës nuk ka respektuar nenin 72 të LPP-së. Paneli shqyrtues konstaton se në bazë të këtij neni mund të kërkohej sqarime dhe disa dokumente shtesë: Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës. Andaj me rastin e rivlerësimit AK duhet të kërkojë sqarime lidhur me dëshmitë e kontestuar nga ankuesi në mënyrë që të vërtetohet se kontratat e ofruar nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës është brenda periudhës kohore të kërkuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së. Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen të përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK –Qendra Klinike Universitare e Kosovës-QKUK
- 1x1 OE–N.P.SH. "Doni Term" – "Gafurr Jashari" B.I. – Drenas,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Z. Goran Milenković

